




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 shkurt 2019 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 10:35.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova dhe Lutfi Bilalli (i cili ka dhënë dorëheqje).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Sylejman Mehulli, Bajrush Kosumi), Fortuna Krasniqi, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Izet Miftari, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe nga sekretaria, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu deklaroi se e kemi edhe një propozim (shqyrtimi i Draft-rregullores për plotësim të rregullores për dhënie të dekoratave) për futje në rend të ditës, e cila u është dërguar edhe në mënyrë elektronike.

Po ashtu, e kemi edhe një njoftim nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, përmes të cilit ka njoftuar për mospërfshirjen në rend të ditës për bartjen e të hyrave vetanake të mbetura nga viti 2018 për shkak të aprovimit me vonesë të buxhetit.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 janar 2019;
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve;
3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për punën gjatë vitit 2018;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/2019;
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale nr. 278/15, e datës 30.12.2015;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018;
8. Të ndryshme.
 - a. Shqyrtimi i Draft-rregullores për plotësim të rregullores për dhënie të dekoratave.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 janar 2019.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 7 të procesverbalit thuhet se <po flitet se në ish-objektin e gjykatës do të ndërtohet hotel>. Ajo deklaroi se këtë nuk e kam thënë kështu, por kam thënë se <Dhënia në shfrytëzim të bëhet në bazë të kriterëve. Pra, mos të jepet në shfrytëzim për një veprimtari tjetër, e më pas shfrytëzuesi ta ndryshojë veprimtarinë>.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 17.1.2019.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi informatë me shkrim deri në mbledhjen e kuvendit për këto çështje: Sa është numri i OJQ-ve në komunën tonë? Sa prej tyre janë aktive? Cilat kanë qenë përfitimet nga këto OJQ? Raport për financim të OJQ-ve për vitin 2018?

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se a kanë plan strategjik OJQ-të për përfitim të subvencioneve nga komuna? Kjo pasi që vetëm po përfitojnë subvencione nga komuna, e në anën tjetër komuna asgjë s'po përfiton nga to.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – pyeti se çfarë parashihet me <subvencionet për rastet e veçanta> tek zyra e kryetarit? Sipas saj, teatri i qytetit e ka të njëjtën shumë si nga viti i kaluar, kështu që ajo kërkoi që të investohet më shumë në kulturë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – theksoi se në bazë të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, kryetari i komunës aprovon ndarjen e subvencioneve për persona juridikë-OJQ deri në 500 €, e që kjo ka të bëjë me rastet e veçanta.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se para ndarjes së subvencioneve, t'iu kërkohet OJQ-ve raporti financiar për shpenzim të mjeteve financiare dhe të ketë kriter se a t'iu vazhdohet përsëri ndarja. Ai po ashtu pyeti se tek kategoria <1.2.3 ndihmë me zahirë familjeve skamnore> a mund të ndryshohet shuma, pasi është shumë e vogël.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – theksoi se kjo shumë është rritur nga viti i kaluar nga 2000 € në 6000 € dhe se këto propozime janë bërë në koordinim me kryetarin e komunës. Me propozim të kuvendit mund të rriten këto shuma financiare, por konsideroj se i kemi planifikuar që të jetë kjo shumë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - lidhur me raportin financiar për OJQ-të, Muzaqi tha se vitin e kaluar u është kërkuar raporti financiar dhe se ne do të këmbëngulim që raporti financiar të jetë kriter për ndarjen e subvencioneve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se tek <financimi i OJQ-ve> nuk bënë që të figurojnë edhe shoqatat e dala nga lufta (OVL, SHFD, SHIL), etj, por duhet të jenë të veçanta si kategori.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – tha se deri në vitin 2017, kuvendi i komunës i ka pasur në kompetencë ndarjen e mjeteve financiare, por nga

viti i kaluar me një rregullore të Ministrisë së Financave, aplikimi është bërë përmes thirrjes publike për OJQ-të.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se duhet të jemi në dijeni se kënd po e financojmë prej OJQ-ve. Ai pyeti se a është e obliguar që të bëhet financimi i vetëm OJQ-ve lokale të Komunës së Vushtrrisë, apo edhe të komunave tjera? Ai kërkoi që t’iu sigurohet transport të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta. Asnjë nxënës me nevoja të veçanta mos të mbetet në shtëpi për shkak të mossigurimit të transportit. Prandaj, qoftë nevoja të rritet edhe kjo shumë financiare për transport të nxënësve nga kjo kategori. Ai përmendi një rast në Stanoc, ku gjendet një fëmijë me nevoja të veçanta dhe nuk është duke iu siguruar transporti.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për punën gjatë vitit 2018.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 3, pika 13 thuhet <kemi rritur të hyrat vetanake dhe numrin e shërbimeve për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, kurse kemi zvogëluar shpenzimet në raport me vitin 2017> Çka ka ndikuar në rritjen e të hyrave vetanake? Për mua është shqetësuese, pse kemi numër më të madh të pacientëve në vitin 2018?

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – deklaroi se është një informatë e mirë, me krahasime të vitit 2018 nga viti 2017.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se është një informatë shumë e mirë. Ai tha që të përmirësohet një gabim teknik në faqen 2 <janar-tetor>, të bëhet <janar-dhjetor>. Po ashtu, në faqen 4 të përmirësohet <projektet kapitale të parapara të realizohen për vitin 2018>, të bëhet projektet kapitale të realizuara për vitin 2018>, pasi që këto janë përfunduar, tha ai. Në faqen 8, thuhet se janë raportuar 29 raste me TBC për vitin 2018. Ai pyeti se a kemi krahasim me vitet paraprake lidhur me sëmundjen e TBC-së, se a është në rritje apo në rënie.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se shikuar në përgjithësi, është një informatë e mirë. Nëse do të bëheshin krahasimet e të hyrave vetanake për tërë komunën, e jo vetëm të drejtorisë, sepse vetëm me një sektor nuk ec komuna përpara. Ajo që më bëri përshtypje është shprehja e përdorur <zbulimi i aparaturës së re në depo të përdorur ndër vite> Fillimisht, mendova mos vallë drejtoria ka bërë një zbulim epokal. Ai kërkoi që të gjendet një shprehje më adekuate për këtë aparaturë, pra p.sh. <të vëhet në përdorim>, <të funksionalizohet>.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – pyeti se për çfarë aparature është fjalë? Edhe kjo thotë që shprehja e përdorur duhet të zëvendësohet me <funksionalizimi i aparaturës>. Në vazhdim ajo konstatoi se aparati i mamografisë duhet të jetë funksional, që është në kuadër të spitalit. Ajo tha se ne si komunë çka mund të bëjmë, në mënyrë që aparati i mamografisë të jetë funksional, pasi që qytetarët kanë nevojë për to.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – e përgëzoi drejtorinë për këtë informatë.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – lidhur me aparatin e mamografisë, tha se e përkrahu si shqetësim, por spitali i Vushtrrisë është nën menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ne nuk kemi kompetenca për këtë. Kuvendi i

komunës mund t'ia dërgojë ministrisë një rekomandim për funksionalizimin e aparaturës, shërbimeve, por edhe për të drejtën e specializimeve nga ky spital. Sepse, i vetmi është spitali i Vushtrrisë që nuk e ka pasur të drejtën e specializimit (herën e fundit), tha Mehulli. Lidhur me gabimet teknike, Mehulli tha se do të përmirësohen. Ndërkaq, lidhur me aparaturën e re që është gjendur në depo e papërdorur, Mehulli tha do ta gjejmë një shprehje dhe për kuvend ta përmirësojmë. Ai tha se këto aparatura janë gjendur në depo: 4 boksa të urgjencës, 6 EKG (që QKMF i ka blerë me mjete të veta dhe kanë mbetur të paketuara). Mehulli theksoi se tani EKG është funksionale si në urgjencë, po ashtu edhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare (me çmim prej 0.50 euro). Lidhur me të hyrat vetanake, Mehulli tha se paraqet të hyrat e drejtorisë që menaxhon dhe secila drejtori i paraqet të hyrat e veta. Ai tha se ndihet mirë që ka arritur t'i rris të hyrat vetanake, madje edhe kemi bërë tejkalim të planifikimit, falë një kontrolli të vazhdueshëm në vijë participimi. Lidhur me rritjen e numrit të pacientëve, Mehulli deklaroi se ky është një lajm i mirë që qytetari ka filluar të besoj në shërbimet që ofrohen nga Qendrat e mjekësisë familjare. Lidhur me tuberkulozin (TBC), ai tha se do të bëjë përpjekje që t'i sigurojë statistikën nga instituti rajonal për vitin 2017. Mehulli deklaroi se ndotja mjedisore dhe trajtimi joefikas i pacientëve janë disa nga shkaqet që ndikojnë te sëmundja e TBC-së.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që të gjitha rastet e keqmenaxhimit me aparatura, të ndriçohen dhe të ndëshkohen fajtorët. Lidhur me këtë, ai tha se si kuvend duhet të kërkojmë informacione se cilat janë masat që janë ndërmarrë ndaj fajtorëve? Ndaj kujt janë marrë ato masa?

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të bëhen disa përmirësime dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/2019.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – pyeti se a është ndërmarrë ndonjë masë nga Drejtoria për Arsim lidhur me suksesin e pamjaftueshëm në nivelin e mesëm të lartë, i cili është shumë i ulët (55.97%)? Pra, a është faji tek nxënësit apo tek drejtorët e shkollave lidhur me këtë. Po ashtu, ajo kërkoi që të angazhohet një mjek në çerdhen publike, nëse jo me orar të plotë, të paktën me orar të kufizuar. Pastaj tek rekomandimet thuhet që <të shtohet buxheti për mjete didaktike>. Ajo pyeti se a ka Drejtoria për Arsim statistika se sa qytetarë kanë nevojë për mësim didaktik?

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se deri në klasën e pestë është një problematikë tjetër, kurse nga klasa e pestë e tutje, paraqitet kjo dukuri. Shqetësimin që e ngriti Rrezarta nuk është vetëm këtë vit, por ka qenë edhe viteve të kaluara. Prandaj, ai pyeti se cilat do të ishin masat që drejtoria parasheh t'i ndërmerr lidhur me këtë, duke shtuar se kemi edhe ngritje të mungesave të paarsyeshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se në nivelin fillor kemi kalueshmëri 99.25%, kurse te arsimi i mesëm i ulët bie në 72.62%, ndërsa te arsimi i mesëm i lartë, suksesi bie në 43.83%. Ai tha se kjo dukuri është përcjellë çdoherë me vite. Prandaj, Drejtoria për Arsim duhet ta bëjë një analizë të thuktë me ekspertë, në mënyrë që të gjendet defekti. Po ashtu, ai kërkoi që të bëhet një analizë se si po bëhet vlerësimi dhe notimi i nxënësve. Në faqen 4, sa i përket bashkëpunimit të shkollës me firmat që nxënësit zhvillojnë praktikën, janë cekur disa firma, por ka edhe firma tjera që nuk janë përfshirë, si “Extracolor”, (ku aktivi kimi-teknologji i shkollës profesionale ka bashkëpunim me këtë firmë). Pastaj, kemi vizita në Muzeun e Mineraleve dhe Kristaleve në Mitrovicë, po ashtu kemi vizituar edhe ujësjellësin në Balincë. Ai kërkoi që të përfshihen në informatë këto. Ai pyeti se sa është shuma e mjeteve financiare që kanë shkuar në

suficit për paga në vitin 2018 nga Drejtoria për Arsim? Është cekur se ka filluar <ndërtimi i punëtorisë për praktikë profesionale në shkollën e mesme teknike>. Kjo për mua është shqetësuese, sepse themelet janë bërë më datë 23-24 dhjetor, ku temperaturat kanë qenë -20 gradë celsius, tha ai. Pra, po bëhet një investim i madh, kurse po e rrezikojmë këtë investim në këto temperatura aq të ulëta. Ai tha se numri i mungesave është shqetësues dhe kërkoi që në shkollat profesionale krahasimi të bëhet në lëndë profesionale në profile të caktuara.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – ajo pyeti se çka po ndodh me këtë degradim në arsim? A po punësohen dhe po transferohen mësimdhënësit në baza klienteliste dhe nepotiste dhe nuk po punësohen njerëzit adekuat që t'i edukojnë dhe arsimojnë fëmijët. A po mungon trekëndëshi nxënës-prind- profesor (arsimtar). Prandaj, duhet ta dimë se nga po vjen ky problem. Arsimi në komunën tonë çdo vit e sipër është duke shkuar në rënie dhe nuk kemi ngritje të cilësisë, tha ajo.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të bëhen disa plotësime dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale nr. 278/15, e datës 30.12.2015.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi që të kthehet prapa dhe t'i bashkëngjitet rregullorja bazë që ta dimë se çka po ndryshohet. Ajo pyeti se a është mbajtur ndonjë diskutim publik për këtë, nëse po të bashkëngjiten procesverbalet e atyre takimeve.

Fortuna Krasniqi, zyrtare nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se arsyeja e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregulloreje është harmonizimi me udhëzimin administrativ. Pra, po përcaktohen kriteret për llogaritjen e taksës ndërtimore, përkatësisht taksës administrative dhe për rritjen e densitetit, ku me udhëzim administrativ kjo është e rregulluar. Mirëpo, kemi pasur vërejtje nga auditori, ku me rregulloren e kaluar është llogaritur taksë bruto për objektin, kurse tash bruto llogaritet taksa administrative, kurse neto llogaritet taksa e densitetit, tha ajo.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se hartuesi (drejtori) nuk është i pranishëm në mbledhje, madje as nuk e ka nënshkruar këtë draft-rregullore, por nënshkruar është një shërbyes civil. Ai pyeti se sipërfaqja neto, a i parasheh sipërfaqet e mureve?

Fortuna Krasniqi, zyrtare nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se në bazë të udhëzimit administrativ, sipërfaqja neto nuk parasheh sipërfaqet e mureve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që ashtu siç e parasheh udhëzimi administrativ të paraqitet edhe në rregullore formula për llogaritjen e sipërfaqes neto, pasi që siç është e shkruar kështu, lë hapësirë për dyshime. Klinaku kërkoi që për kuvend, ky propozim të nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë dhe të jetë i pranishëm në mbledhjen e kuvendit.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – u zotua se nga mbledhja e ardhshme, secili drejtor do të jetë i pranishëm në mbledhje, ose do ta dërgojë përfaqësuesin e tyre.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota “për” dhe një (1) “abstenim” rekomandoi që të bëhen disa plotësime dhe t'i bashkëngjitet rregullorja bazike dhe ta procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 3 thuhet që ka pasur ulje të aksidenteve, por verës rritet fluksi i qarkullimit të veturave në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë. Ajo pyeti se a ka ndërmarrë ndonjë hap komuna në bashkëpunim me policinë për zgjidhjen e problemit të kolonave të gjata? Si pasojë e këtyre kolonave, po shkaktohen edhe aksidente.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se kemi pasur takime disa herë me përfaqësues të Ministrisë për Infrastrukturë, ku me kërkesë tonë janë vendosur edhe semaforët. Po ashtu, kemi pasur takime edhe me përfaqësues të policisë së Kosovës, ndërsa policia u ankua se ka mungesë të stafit, por brenda mundësive në kohën e pikut (koha kur qarkullimi është i shtuar) u zotuan që të shtohet numri i policëve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në fushatë po jepen premtime, e në praktikë nuk po realizohen.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – tha se për statistikën që i ka jep policia është mirë që të bëhen krahasime me vitet paraprake në mënyrë që të dihet se cili është trendi. Ai kërkoi që t’iu përcillen policisë këto vërejtje dhe për kuvend të na i sjellin këto krahasime.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – kërkoi që të bëhen krahasime edhe tek veprat penale kundër narkotikëve. Po ashtu, do të ishte mirë që të ceket edhe mosha më e prekur në këtë fushë.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – kërkoi që Drejtoria për Arsim së bashku me drejtoritë e shkollave, të angazhohen dhe ta kenë stafin e vet për mbajtjen e ligjëratave lidhur me dukuritë negative në shoqëri. Këto ligjërata t’i mbajnë ekspertët e fushave, në mënyrë që të binden për pasojat e dukurive negative e jo të nxitën nxënësit ta provojnë, drogën, duhanin etj. Ajo shtoi se në disa ligjërata që ka marrë pjesë, e të cilat i ka mbajtur policia, ligjëruesit më tepër i frymëzonin nxënësit që ta provojnë drogën, sesa që i kanë larguar prej saj. Ajo kërkoi nga Drejtoria për Arsim që të ketë kontroll lidhur me ligjëratat që mbahen në shkolla. Po ashtu, ata që i mbajnë ligjëratat të jenë njerëz të trajnuar, në mënyrë që t’i vetëdijësojnë nxënësit për dukuritë negative në shoqëri dhe për pasojat e tyre.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet me krahasime të statistikave dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se kohëve të fundit ishte një incident në komunën tonë që qeni endacak kafshoi një fëmijë. Edhe pse kjo informatë është për vitin e kaluar, ajo që më bëri përshtypje është se në këtë informatë nuk është përfshirë fare dukuria e qenve endacakë. Kryetari në fillim dha fjalë të mëdha në fillim të mandatit që do të merret seriozisht me dukurinë e qenve endacakë dhe do ta zgjidh këtë problem. Mirëpo, më vonë e pa që nuk është e lehtë të zgjidhet kjo çështje. Edhe në mandatin e kaluar e kam thënë, por edhe tash në kuvend e kam thënë që nëse nuk merret Qeveria e Kosovës me këtë problem, komunat nuk do të mund ta zgjidhin këtë, tha Klinaku. Ajo që më bëri përshtypje është që në këtë informatë nuk është

përfshirë fare dukuria e qenve endacakë. A po i bie kjo që KKSBB nuk është marrë fare me këtë dukuri?

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – dukuria e qenve endacakë është një problem në tërë Kosovën dhe të gjithë jemi dëshmitarë për rreziqet nga qentë.

Bajrush Kosumi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – theksoi se deri në fund të vitit kemi kontratë me kompaninë. Kemi kontaktuar përfaqësuesit e kësaj kompanie dhe do të takohemi të hënën dhe do të shikojmë se cilët do të jenë hapat në këtë drejtim. Kosumi tha se në çdo mbledhje të KKSBB-së është trajtuar dukuria dhe shqetësimet nga qentë endacakë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se edhe pse nuk është anëtar i KKSBB-së, në disa mbledhje kam marrë pjesë dhe është trajtuar si shqetësim dukuria e qenve endacakë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet me çështjen e trajtimit të qenve endacakë dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

8. Të ndryshme.

a. Shqyrtimi i draft-rregullores për plotësim të rregullores për dhënie të dekoratave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se është dashur këtij dokumenti t'i bashkëngjitet edhe rregullorja bazë. Ai tha se para disa muajve, kryetari i komunës në kuvendin komunal ka dhënë <titull>, e jo <çmim>, “emblema e Vushtrrisë”, kurse në rregulloren bazë është <çmim> dhe po ashtu edhe në këtë draft. Nga praktikat që kam parë në shumë shtete të Evropës, por edhe në Shqipëri, jepet <çmim> “emblema e qytetit”. Për shkak se në Kosovë mungon një ligj për dekoratat, derisa Ligji për Vetëqeverisjen Lokale thotë vetëm se komuna mund të japë dekorata, dhe se nuk kemi kriteret se në cilat raste mund të jepen këto dekorata. Klinaku tha se nëse i është dhënë Vafije Goodman <titulli> “Emblema e Vushtrrisë”, atëherë në këtë draft duhet ta ndryshojmë nga <çmimi> në <titull>. Ai pyeti se në çka janë bazuar lidhur me këtë përkufizim: <Çmimi “Emblema e Vushtrrisë” iu jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Vushtrrisë, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në rrafshin kombëtar, që janë personalitete të rëndësishme në fusha të veçanta.....”. Ai propozoi që t'i kthehet drejtorisë kjo draft-rregullore dhe të bisedojnë me kryetarin.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se do ta analizojmë këtë çështje dhe për kuvend. Ai sugjeroi që kjo të procedohet në kuvend, pas korrigjimeve që do të bëhen nga qeveria komunale.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se edhe dilema ime ka qenë tek çështja <titull>, <çmim>. Unë kisha propozuar që të mbetet <titull> në rregullore. Ajo kërkoi që të përcaktohet diametri i pllakëzës se sa do të jetë, si dhe tha se nuk pajtohet që pllakëza të jetë e praruar në ar e po ashtu edhe kundër që t'i jepen mjete financiare.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi që në pikën 1.1 të analizohet formulimi <Çmimi “Emblema e Vushtrrisë” iu jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Vushtrrisë, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në rrafshin kombëtar>. Ajo po ashtu tha se nuk pajtohet me propozimin që është dhënë në pikën 1.6 për ndarje të mjeteve financiare në shumën prej 500€. Unë konsideroj që s'ka nevojë fare t'i jepen mjete financiare, përderisa po merr një pllakëz të praruar në ar.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – ai tha se ari është një prej metaleve më të çmuara dhe kërkoi që të specifikohet vlera ose masa e ari që do të përdoret në pllakëz.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se lidhur me këtë kam një shqetësim, sepse përmes këtyre çmimeve dhe dekoratave mundohen gjithmonë ta gjejnë një mënyrë për të tërhequr vota nga ato familje. Sipas saj, këto politika janë të paramenduara mirë. Ajo lidhur me këtë tha, edhe unë pajtohem që nuk ka nevojë të jepen as mjete financiare e as ari.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të analizohet se a të figurojë në këtë draft-rregullore fjala “çmim” apo “titull”, po ashtu dimensionet e pllakëzës të përcaktohen, kurse pjesa ku thuhet <e praruar në ar> të hiqet. Çmimi në vlerë prej 500€ të hiqet në tërësi. Pas këtyre përmirësimeve të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – paraqiti shqetësimin e saj lidhur me hedhjen e mbeturinave tek ura në fshatin Pestovë.

- Ajo kërkoi informatë me shkrim se a janë bërë inspektime nga ana e inspektorëve tek ura e Pestovës, pasi që ka prapë hedhje të mbeturinave?
- Ajo kërkoi informatë me shkrim se a po bëhet presion ndaj Ministrisë së Infrastrukturës për përsheptimin e punimeve të urës në fshatin Pestovë?
- A është planifikuar ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen “Curri” dhe “Selimi” në fshatin Reznik?

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi informatë me shkrim se pse po kushtëzohen qytetarët për regjistrim të veturave me pagesën e taksës për mbeturina? Lidhur me këtë tha se kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Tutje tha se kam lexuar nëpër rrjete sociale, se kryetari i komunës e ka paguar emisionin “Talk” në KTV në vlerë prej 7000€, por a e ka paguar nga buxheti i tij individual, apo e ka paguar nga taksat e qytetarëve mbetet të shihet. Sepse, këtë pyetje do t’ia bëjë në kuvend kryetarit, theksoi Klinaku. Mandej deklaroi se kryetari i komunës po manipulon me qytetarët, me transparencën e tij, shpenzime prej 13 euro në javë. Por, nëse i llogarisim shpenzimet e zyrës së kryetarit për vitin 2018 del që kjo zyrë ka harxhuar 877 euro në ditë. Këto shpenzime duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës tek rubrika ku është e paraparë. Në fund kërkoi edhe nga kryesuesi i kuvendit që ligjshmërinë e vendimeve të kuvendit të komunës që i dërgon MAPL-ja të na i dërgojë neve si anëtarë të kuvendit që të jemi në dijeni.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi që të hiqen kontejnerët që gjenden para çerdhes publike, pasi që ka ankesa nga qytetarët. Po ashtu, ajo pyeti se pse punëtorët e kompanisë “Uniteti” nuk kanë marrë paga?

Mbledhja përfundoi në orën **13:15**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së

